

## Analiza e situates mjedisore ne Qarkun Diber

Qarku i Dibres shtrihet ne verilindje te Shqiperise , ne rrjedhjen e mesme te lumit Drini i zi dhe lumit Mat. Qarku ka nje siperfaqe totale prej 188571 ha. Terreni eshte kryesisht kodrinoro-malor ndersa zona fushore dhe kodrinore jane baze e zhvillimit te prodhimit bujqesor ku gjithashtu sigurohen dhe nje sere prodhimesh te arrave dhe drureve te tjere frutore por dhe bime mjeksore. Kurse malet dhe luginat perbejne burime te medha pyjore dhe kullosore si ponteciale te prdhimeve pyjore e vecanerisht te arroveve ku vend te rendesishem zene Lajthia dhe Geshtenja.

### Mjedisi

Ne pergjithesi mjedisi nuk eshte shume i ndotur per shkak se nuk eshte nje rajon i ish industrializuar.

Qarku i Dibres ndodhet ne basenet e lumit Mat dhe Drini i Zi. Edhe pse nuk ka te dhena, uji i ketyre lumenjve konsiderohet i cilesise se mire dhe niveli i ndotjes (duke mos marre parasysh shkarkimin e ndotesve dhe ndertimet) eshte i ulet. Lumi i Drinit te Zi buron nga Liqeni i Ohrit dhe rrjedh mes terrenit malor qe rrit forcen e ujit dhe e ben ate te pershtatshem per perdorim hidrocentrali. Lumi i Matit buron nga gryka e Kaptines dhe rrjedh drejt liqenit artificial te Ulzes.

### Treguesit e cilesise se ujit te lumenjve (2010)

Lumi	Oksigjeni i shperbere (DO) per mg/l	Nitrate (NO3 mg/l)	Rrjedha e ujit (m <sup>3</sup> /sec)
Drini i Zi	8.5 – 9.91 mg/l	0.26 – 0.3 mg/l	103 m <sup>3</sup> /sec
Mati	9.23 – 10.3 mg/l	0.37 – 2.26 mg/l	-

Analize e ujerave nentokesore ne basenet e Drinit dhe Matit paraqitet me cilesi fiziko-kimike te mira ne pergjithesi me kushte higjeno-sanitare te mira. Ne zonat e monitoruara ujerat nentokesore plotesojne normat e lejuara per uje te pijshem. Aktualisht jane ne pune shtate hidrocentrale me nje kapacitet te instaluar prej 55 ME. Pritet qe se shpejti te futen ne pune shtate hidrocentrale te reja te vegjel, me nje kapacitet total prej 40 ME. Drini i zi dhe Mati. Drini i Zi buron nga liqeni i Ohrit, ai pershkron nje relief mjaft te thyer me zgjerime dhe ngushtime ,madje dhe gryka te ngushta te pershtatshme per ndertimin e hidrocentraleve. Drini merr me vete disa dege: zallin e Bulqizes, Seta, Veleshica, Murra etj. Keta dege kane karakter te vrullshem dhe me prurje te medha ne kohen e shkrirjes se bores. Perberja e oksigjenit e tretur ne lumin Drin rezulton te jete ne vlerat nga 8.5 ne 9.91 mg/l oksigjen. Vlera e nitratit luhetet nga 0.3 0.26 mg/l. Ujerat e ketij lumi klasifikohen me cilesi mesatare. Ka prurje mesatare rreth 103 meter kub/sek.

Ndotja e ujit siperfaqesor ne lumenj te Drini i Zi dhe Mat eshte shume i ulet ne krahasim me lumenjte e tjere ne Shqiperi. Ndotja e ajrit eshte minimale, sepse qarku nuk ka industri te rende. Gjenerimi i mbetjes urbane ne nivel rajonal eshte ne masen 42% te mesatares kombetare. Mbetjet urbane ne bashki jane 0.23 ton/banor be 256% mesatares rajonale.

Shume vendbanime nuk kane sisteme te menaxhimit te mbetjeve dhe te kanalizimeve. Kushtet natyrore, qe nuk lejojne per urbanizim te madh, dhe me shkembimet e shpejta te ajrit/ujit, krijon nje sistem dinamik mjedisor. Presionet mbi mjedisin jane te vogla dhe lidhen me se shumti me mbetjet vendore. Sistemi i mbetjeve dhe kanalizimeve jane shume pak te zhvilluara si per infrastrukturen ashtu edhe per administrimin e tyre. Perdorim i qendrueshem i burimeve te pasura natyrore duhet te perbeje nje perparesi. Investimet dhe permiresimet ne organizimin e sherbimeve jane te nevojshme, veçanerisht ne fushen e administrimit te mbetjeve. Nevojitet nje promovim dhe ndergjegjesim me i madh per pergjegjshmerine mjedisore. Duhet te merret parasysh bashkimi i njesive vendore si nje mjet per zbatimin e vendimeve strategjike ne fushen e administrimit te mbetjeve.

Ne Parkun Kombetar te Lures me siperfaqe 1280 ha ndodhen 14 liqene akullnajore nga te cilet 7 mbajne uje gjithe vitin. Ofrojne nje flore te larmishme me lule shumengjyreshe te rrethuar nga drure halore dhe fletore. Liqenet kryesore jane: Liqeni i Madh me siperfaqe 11,8 ha gjeresi 300m, thellesi 20m, dhe lartesi nga niveli detit 1722m. Liqeni i Kallabes me siperfaqe 3,6 ha, thellesi 12m, dhe lartesi nga niveli detit 1575m. Liqeni i Zi me siperfaqe 2.5, thellesi 10m, dhe lartesi nga niveli detit 1620m. Liqeni i Luleve me siperfaqe 1,44 ha, thellesi 0,8m, dhe lartesi nga niveli detit 1585m.

### **Mbetjet urbane dhe furnizimi me uje**

Gjenerimi i mbetjeve te ngurta urbane ka nje tendence ne rritje duke e krahasuar me vitet e meparshme. Mbetjet inerte kane nje tendence ulje ne krahasim me mbetjet shtepiake dhe tregtare. Megjithatë perpjekjet dhe permiresimet ne fushen e menaxhimit te mbetjeve, perseri mbetet problem depozitimi i tyre ne vendet e papershtatshme, dhe veçanerisht djegia e tyre ne mjedise te hapura, tymi dhe gazet e te ciles perbejne problem serioz per shendetin dhe mjedisin perreth. Problem mbetet mungesa e sistemit te grumbullimit dhe depozitimit te mbetjeve urbane ne zonat rurale. Aksesit ne furnizimin me uje te pijshem dhe ne trajtimin e ujerave te zeza—74% e popullsisë se te gjithë qarkut ka akses ne sistemin e ujit te pijshem, qe perben nje permiresim me 47% ne periudhen 2002-2010. Ndryshimet kane qene me te konsiderueshme ne bashki (me nje rritje 82% rritje) ne krahasim me komunat (9%). Ne 9 komuna lidhjet aktuale ne rrjetet e ujit te pijshem jane ne nivelin e 90 – 100% te popullsisë. Situata eshte me e keqe ne trajtimin e ujerave te zeza.

Ne Qarkun Diber mbizoteron funksionimi i sheshe te depozitimit duke theksuar qe nuk ka ne funksion ndonje landfill industrial per depozitimin dhe trajtimin e tyre. Gjenerimi i mbetjes urbane ne nivel rajonal eshte ne masen 42% te mesatares kombetare. Disa nga Njesite e Qeverisjes Vendore te Qarkut diber kane vetem vend-depozitime dhe te tjerat mbetjet i asgjesojne ne menyre te paligjshme, ngelet nje nder problemet kryesore menaxhimi i mbetjeve urbane ne rajonin tone. Siç shihet ne dy tabelat e mesipeme ku jane shfaqur nje permbledhje e mbetjeve urbane dhe inerte te 2 viteve te fundit kemi nje rritje te mbetjeve si rezultat i vazhdimit te ndertimeve si dhe rritja importeve te mallrave te konsumit si ato ushqimor dhe tekstile. Siç eshte theksuar dhe ne strategjine e zvhillimit

rajonat Diber menyrat e mundeshme per permisim ngelen: perdorim i qendrueshem i burimeve te pasura natyrore duhet te perbeje nje perparesi. Investimet dhe permiresimet ne organizimin e sherbimeve jane te nevojshme, veçanerisht ne fushen e administrimit te mbetjeve. Nevojitet nje promovim dhe ndergjegjesim me i madh per pergjegjshmerine mjedisore. Megjithese NJQV jane te detyruara te sigurojne sherbimin e grumbullimit, largimit dhe trajtimit te mbetjeve, problemi qendron kryesisht ne zinxhirin e manaxhimit te mbetjeve. Menyra kryesore e trajtimit te mbetjeve eshte thjesht hedhja e tyre ne fushe te hapur dhe djegia e tyre e vazhdueshme aty ku jane, duke sjelle nje rrezik te papranueshem per shendetin dhe sigurine e banoreve perreth. Lidhja me sistemin e ujit te pijshem dhe trajtimin e ujerave te zeza eshte ende e dobet dhe kjo kerkon investime te medha. Mbeten ende disa sfida per t'u trajtuar ne nivel rajonal, administrimi i mbetjeve kerkon nje ristrukturim te ketij sektori per ta bere ate me efikas per t'iu pergjigjur realiteteve te reja qe shoqerojne levizjet e popullsise dhe urbanizimin.

Ne Qarkun Diber dy jane format me te demshme te erozionit, ai siperfaqesor i tokes nga uji, dhe humbjet si pasoje e shkarjeve dhe shembjet e tokes. Gjate viteve te fundit si rezultat i reshjeve te shumta dhe me intesitet te larte, ka patur demtime ne toka bujqesore. Ne keto kushte ka patur permbytje, erozion dhe gerryerje nga lumi Drin i Zi, kjo me e dukshme ne zonen ku ky lume bashkohet me zonen e Zallit te Bulqizes.

## **PYJET**

Qarku i Dibres dallohet per pasuri te medha pyjore. Pyjet zene rreth 60% te siperfaqes se tij dhe siperfaqe e mbuluar eshte rreth 3 here me e madhe se e tokes are, gje qe tregon se fondi pyjor perben per Qarkun nje potencial te rendesishem mjedisor dhe ekonomik. Relievi dhe klima e Qarkut bejne qe aty te ndodhen te gjitha katet bimore te vendit tone, duke filluar me shkuret mesdhetare deri ne livadhet alpine. Brezi i dushkut shtrihet ne lartesine 800 m mbi nivelin e detit, ne lartesine 900 – 2000 m mbi nivelin e detit shtrihet brezi i ahut. Ne vitet e fundit ne Qarkun e Dibres ka pasur demtime te ndjeshme, ku demtimet me te medha kane ardhur nga prerjet abuzive, zjarret dhe nga mbikullotja. Qe nga viti 2008 mbi 70 % e siperfaqes pyjore e kullimore ka kaluar ne pronesi te NjQV-ve te cilat nuk kane stafin dhe njohurit e nevojshme per t'i menaxhuar ne menyre te qendrueshme duke plotesuar nevojat e veta dhe te banoreve te tyre. Ne pergjithesi demtimet kane qene me te medha se investimet per ripertitjen e pyjeve, edhe pse siperfaqja e mbuluar ne shumicen e komunave nga pyjet eshte disa here me e madhe se ajo e tokes are, vlersimi per pyjet eshte i pakte.

Me kalimin e viteve sektori i pyjeve dhe kullotave ka filluar te konsiledohet ku ne vitet e fundit eshte bere nje hap para duke ju kaluar nje pjese e konsiderueshme , rreth 40 % ne pronesi dhe perdorim te njesise se qeverisjes vendore, komunave dhe bashkive te vendit. Sic shihet dhe ne tabela e mesiperme siperfaqet ne njesite e qeverisjes vendore ne ha jane rritur ne 2012 ne krahasim me nje vit me perpara. Theksojme qe pyjet ne Qarkun Diber rrezikun me te madhe e kane nga prerja abuzive dhe djegia ku si pyje dhe bime te rrezikuara permendim: Xherrokull , Lajthi e eger, Fier mashkull, Frasherit zi, Dellenje e kuqe, Salep, Rigon, Shtog i zi , Shtug i kuq, veshtull etj

## Biodiversiteti

Qarku Diber ka nje larmi te madhe biologjike dhe peizashore. Ne origjinen e kesaj shumellojshmerie qendrojne: pozicioni gjeografik, faktoret gjeologjik, hidrologjike, relievi dhe klima. Larmia e ekosistemeve dhe habitateve si ( delta lumenjsh, liqene, shkurreta mesdhetare, pyje gjethegjere, halore dhe te perzjere, livadhe dhe kullota alpine ) ofron nje larmi te pasur llje bimoresh dhe shtazosh. Ne kuadrin e pegjithshem te vlersimit dhe menaxhimit te burimeve natyrore si dhe mbrotjes se mjedisit nje vend me rendesi ze dhe Qarku i Dibres me disa siperfaqe te caktuara ne rretin e Zonave te Mbrojtura, bazuar kjo ne kategorine e tyre dhe jane shpallur si me poshte:

Zonat e Mbrojtura ne Qarkun Diber jane:

<b>Nr.</b>	<b>Kategoria</b>	<b>Nr.ZM</b>	<b>Rrethi</b>	<b>Emeri I ZM</b>	<b>Miratimi</b>	<b>Siperfaqe ne HA</b>
1	II	2	Diber	Lura	VKM nr. 92, date 21.11.1966	1280
2	II	8	Mat	Zall Gjoçaj	VKM nr. 102 date 15.01.1996	140
3	III	6	Diber	Vlashaj	VKM nr. 102 date 15.01.1996	50
4	VI	1	Diber	Luzni - Bulaç	VKM nr. 102 date 15.01.1996	5900

Fauna e eger qe pjesa me e madhe shumohen dhe jetojne neper habitate pyjore dhe kollusore. Llojet kryesore te faunes se eger si kafshe permendim: Ujku, Dhelpra, Ariu, Lepuri, Rreqebulli etj, dhe shpende si: Pellumbat e eger, Thelleza, Grifsha, Shqiponja, Bilbilat, Mellenjat, Qukapiket, Gushkuqet, Harabelet.